

Grupi i njëjtë i policëve ka ardhur pastaj te shtëpia e Ibrahim Hajdes. I morën me vete të gjithë burrat dhe gratë. Pastaj, një grup tjetër i policëve i ka çuar në burg në Prizren. Pas lirimimit nga burgu ata u kthyen dhe e gjetën shtëpinë të boshatisur. Në krevatin në të cilin Haxhiu ka mbetur i shtrirë i kanë gjetur tri gëzhoja. Mungonte batanija me të cilin ai mbulohej. Zhdukjen e tij nuk e kanë paraqitur te KNKK-ja.

**Burimet:** deklarata S.H., FDH-40779, FDH-40756; J. Osmani, *Krimet...*, II, 243.

### **Hidajet (Fejzullah) Haxhijaha**

(15.01.1930, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, bujk, shtatë fëmijë)

Bashkëshortja e Hidajetit dhe djemtë me familje të veta e braktisën shtëpinë rreth orës 09:00, më **19.07.1998**. Hidajeti u vonua duke e lëshuar bagëtinë nga ahuri. Kur djali i tij Nexhmedini kuptoi se i ati nuk ishte me ta, u kthye që ta merrte atë në shtëpi [Rahovec/Orahovac]. Por, në oborr i gjeti dy policë serbë në uniforma të ngjyrës së gjelbër, të cilët menjëherë hapën zjarr drejt tij, por nuk e qëlluan. Nexhmedini ia arriti që të arratiset. Familjarët e Hidajetit u strehuan në Mamushë/Mamuša dhe, për një kohë, nuk dinin asgjë për fatin e Hidajetit. Nexhmedini dhe djali tjetër i Hidajetit, Reshati, u kthyen në qytet më 11.09.1998. E zbuluan trupin e të atit në katin e dytë të shtëpisë së djegur familjare. E ftuan policinë, e cila e kreu hetimin e vendngjarjes. Në xhepat e tij e gjetën një orë të dorës dhe këllëfin e gjyzykëve. Në një gisht të dorës së tij të djegur ende ishte unaza. Pranë kufomës së Hidajetit e gjetën edhe çelësin e kasafortës, e cila ishte e plaçkitur. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Hidajetit në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac më 12.09.1998.

**Burimet:** deklarata A.S, FDH-2100; LBI, *Preliminar...*, FDH-3631; deklarata R.H, FDH-33633; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 138; KMKRFF, *Personat...*, FDH-10832.

### **Fadil (Hasan) Haxhimustafa**

(31.07.1978, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac)

Fadili jetonte në bashkësi familjare me nënën dhe motrën. Nëna kujdesej për Fadilin tërë kohën, ngase vuante nga problemet psikike. I ati i kishte ndërruar jetë para luftës. Në datën **19.07.1998**, shkuan te kushëriri Qamil Haxhimustafa, i cili e kishte shtëpinë me bodrum [Rahovec/Orahovac]. Atje ishte strehuar një numër i madh njerëzish. Për një çast, motra e Fadilit deshi të shkonte në tualet në shtëpinë e vet. Nëna e saj e shoqëroi, por kur u kthyen në bodrum aty nuk e gjetën askënd. Të gjithë ishin larguar, përfshirë edhe Fadilin. Më vonë, nëna e Fadilit kishte mësuar se njerëz, që ishin të strehuar në bodrum, e kishin lënë Fadilin që të priste të ëmën, kur ata vendosën të largoheshin nga bodrumi. Nga ajo ditë, Fadilit i humbet çdo gjurmë. Familjarët nuk kishin kurrfarë njohurish për atë deri në muajin gusht të vitit 2007, kur u identifikuan mbetjet e tij mortore. Vetëm atëherë mësuan se mbetjet mortore të Fadilit ishin zhvarrosur nga varret që ishin pranë gropës me bërllok [prapa varrezave myslimane]. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Fadilit në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac, më 20.08.2007.

**Burimet:** deklarata R.D, FDH-12929; Prokuroria Publike e Qarkut në Prizren, Kt. num. 83/99 (A. Kolašinac dhe të tjerë), aktakuzat, 07.08.2000, FDH-8705; OMPF, *Mbetjet...*, FDH-15297.

### **Borivoje (Risto) Simić**

(5.09.1925, serb nga Rahoveci/Orahovac, pensionist, dy fëmijë)

### **Jagoš (Arsenije) Fildokić**

(29.07.1956, serb nga Rahoveci/Orahovac, mjeshtër, tre fëmijë)

### **Vekoslav (Stanoje) Kazić**

(16.09.1966, serb nga Rahoveci/Orahovac, tre fëmijë)

Borivoje, Jagoši dhe Vekoslavi kanë jetuar në lagjen serbe, e cila shtrihet në pjesën e qytetit përmbi kishë ortodokse. Në datën **19.07.1998**, rreth mesditës, ata shkuan për një vizitë te dhëndri në skaj të lagjes serbe, nga ky fillon pjesa shqiptare e **Rahovecit/Orahovac**. Përderisa qëndronin në këmbë,